




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 dt. 06.11.2014, me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të datës 22.03.2018, dhe në zbatim të nenit 8 paragrafi 8 i Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencione e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.2/2018 01nr.016-28468 dt.22.03.2018 Kryetari i Komunës së Gjilanit merr këtë:

V E N D I M

për

anulim të Thirrjes publike të datës 25.10.2022 të Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari për aplikim për sera të zinguar

1. Anullohet Thirrja publike e datës 25.10.2022 e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë për aplikim për sera të zinguar.
2. Anulimi i Thirrjes publike të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet për shkak të mosrespektimit të procedurave të përcaktuara me Rregulloren për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencione e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.2/2018 01nr.016-28468 dt.22.03.2018.
3. Obligohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë, që në afat të arsyeshëm të shpallë Thirrjen publike për aplikim për sera të zinguar, duke u bazuar në Rregulloren për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencione e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.2/2018 01nr.016-28468 dt.20.03.2018.
4. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të tij.

Vendimi i dorëzohet:

- DBP dhe
- Arkivit





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIKA OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT



OPSTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GJILAN BELEDIYESI

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë / Uprava Poljoprivrede i šumarstva /
Department of Agriculture and Forestry

Në mbështetje të ligjit për "Vetqeverisje Lokale" nr.03/L-040, neni 62, pika 3, rregullorës komunale për subvencione nr. 16 - 126422, si dhe duke u bazuar në planin e punës për vitin 2022, Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë shpall:

FTESË PËR APLIKIM PËR SERRA TË ZINGUARA

Në projekt është paraparë ndërtimi, montimi dhe vendosja e folisë për **pesëdhjetë e pesë (55)** serra me sipërfaqe prej **50 m²** ose **10 x 5 m**.

Tipi i serrës : Tunnel me dimensione : **10 m gjatësi x 5 m gjerësi x 3.2 m lartësi**.

KUSHTET PËR APLIKIM

- Fermeri duhet të jetë banor i Komunës së Gjilanit.
- Të posedojë tokë të përshtatshme për kultivimin e perimeve dhe sipërfaq të mjaftueshme për vendosjen e serrës.
- Fermerët përfitues të serrave familjare, duhet të **participojnë me 20 %** të vlerës së serrës në llogarinë e Komunës.
- Të posedojë burim të ujit të përshtatshëm për ujitje të perimeve.
- Të kenë përvojë në kultivimin e perimeve.

Dokumentet e nevojshme:

- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës.
 - Vërtetimi mbi tatimin në pronë (originalin).
 - Fleta poseduese mbi tokën (originalin).
 - Skica e parcelës në të cilën do të ngritët serra.
 - Përparësi kanë fermerët të cilët nuk kanë përfituar më parë, dhe ata të cilët bujqësinë e kanë aktivitet primar **pa të ardhura financiare**.
- Përfituesit do të nënshkruajnë marrëveshje me Drejtorinë për Bujqësi dhe Pylltari me të cilën obligohet që të mos e tjetërsojë serrën.

Afati i aplikimit fillon nga data 25.10.2022 deri më 09.11.2022

Aplikacionet dorëzohen në **Qendren për Shërbim me Qytetarë në Gjilan**

Gjilan 25.10.2022

Drejtori i D.B.P ing.Bajram Isufi



Formulari nr.2

APLIKACIONI PËR SERRA TË ZINGUARA

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë

Emri dhe Mbiemri : _____

Person Fizik / juridik: _____

Me adresë : _____

Projekti: ____ Serra të Zinguara

Aplikimi për serra të zinguara 50m²:

Telefoni: _____

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

Kopia e leternjoftimit të Republikës së Kosovës	
Vërtetimi mbi tatimin në pronë (original)	
Fleta poseduese mbi pronën (original),	
. Skica e Parcellës në të cilën ngritet serra (Original)	
Deklaratë e noterizuar, në raste kur prona nukë është e rregulluar	

Parashtruesi i kërkesës:	
Nënshkrimi:	
Data:	